



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:067986
Datë: 08.04.2024
Numri i dokumentit: 05558146

C.nr.389/22

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin individual Fuad Haliti dhe me bashkëpunëtorin profesional Eron Prekazi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve 1.Sh...P..., 2.N...Zh..., 3.Sh...R.... U., 4.S...J..., dhe 5.G...A... nga Mitrovica, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av.Leutrim Ademi nga Mitrovica, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës, Drejtoria Komunale e Arsimit të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Lirim Zeka, avokat me seli në Prishtinë, me objekt kontesti: kompensimi për shkallë të inflacionit, jashtë seancës gjyqësore, me datë 08.04.2024, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësve 1.Sh...P..., 2.N...Zh..., 3.Sh...R.... U., 4.S...J..., dhe 5.G...A... nga Mitrovica.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve, në emër të kompensimit për shkallë të inflacionit, t'i kompensoj si vijon:

- Paditësit Sh...P..., në emër të kompensimit për shkallë të inflacionit për vitin 2021 dhe vitin 2022 (periudhën Janar 2021 e deri me 22 Nëntor 2022), shumën prej 808.11€;
- Paditësit N...Zh..., në emër të kompensimit për shkallë të inflacionit për vitin 2021 dhe vitin 2022 (periudhën Janar 2021 e deri me 22 Nëntor 2022), shumën prej 817.64€;
- Paditësit Sh...R.... U., në emër të kompensimit për shkallë të inflacionit për vitin 2021 dhe vitin 2022 (periudhën nga data 01.05.2021 e deri me 22 Nëntor 2022), shumën prej 823.59€;
- Paditësit S...J..., në emër të kompensimit për shkallë të inflacionit për vitin 2021 dhe vitin 2022 (periudhën Janar 2021 e deri me 22 Nëntor 2022), shumën prej 775.65€;
- Paditësit G...A..., në emër të kompensimit për shkallë të inflacionit për vitin 2021 dhe vitin 2022 (periudhën Janar 2021 e deri me 22 Nëntor 2022), shumën prej 828.18€;

III. DETYROHET e paditura Komuna e Mitrovicës, që paditësve t'ia kompensoj detyrimin nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kamatë prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë (datë 04.04.2022) dhe t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 333.00€, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

IV. REFUZOHET kërkesëpapia e paditësve 1.Sh...P..., 2.N...Zh..., 3.Sh...R.... U., 4.S...J..., dhe 5.G...A... nga Mitrovica, lidhur me kompensimin për shkallë të inflacionit, si në vijim:

- Paditësit Sh...P... në emër të kompensimit për shkallë të inflacionit për periudhën 23.11.2022 deri me 30.11.2022, shumën prej 15.48 €;
- Paditësit N...Zh..., në emër të kompensimit për shkallë të inflacionit për periudhën 23.11.2022 deri me 30.11.2022, shumën prej 8.91€;
- Paditësit S...J..., në emër të kompensimit për shkallë të inflacionit për periudhën 23.11.2022 deri me 30.11.2022, shumën prej 15.01€.
- Paditësit G...A..., në emër të kompensimit për shkallë të inflacionit për periudhën 23.11.2022 deri me 30.11.2022, shumën prej 15.86 €.

Arsyetim

1. Pretendimet e palëve

Paditësit, me datën 04.04.2022, pranë kësaj gjykate kanë paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës dhe të precizuar përmes parashtresës me datë 22.11.2023, me anë të së cilës kanë kërkuar që të obligohet e paditura që paditësve t’ia paguaj në emër të kompensimit sipas shkallës së inflacionit për periudhën Janar – Dhjetor 2021 dhe Janar – Nëntor 2022. Shpenzimet e procedurës i kërkojë dhe të njejtat i precizojë me parashtresën e datës 22.11.2023.

E paditura, me datë 26.02.2024, me anë të përgjigjes në padi ka kontestuar pjesërisht kërkesëpadianë dhe atë për muajt Janar 2021 para hyrjes në fuqi të Kontratës Kolektive dhe për muajin Nëntor 2022 pas shkëputjes së Kontratës Kolektive.

2. Provat e administruara

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka vlerësuar provat si në vijim: listën e pagave për paditësit për muajin Maj 2021.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8, 398 dhe 399 të LPK, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit jashtë seancës ashtu që me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku duke gjetur se kërkesëpapia e paditësve është **pjesërisht e bazuar**.

3. Faktet

Me leximin e listës së pagave për paditësit për muajin Maj 2021, gjykata vërtetojë faktin se paditësja Sh...P... ka pagën në shumën prej 489.07€, N...Zh... ka pagën në lartësi prej 491.03€, Sh...R.... U.. ka pagën në lartësi prej 507.08€, S...J... ka pagën në lartësi prej 469.51€, dhe G...A... ka pagën në lartësi prej 469.51€.

4. Baza Ligjore

Sipas nenit 35 paragrafi 10 i Kontratës Kolektive numër 2056 e datës 18.04.2017 dhe neni 35, paragrafi 10 i Kontratës Kolektive nr. 105 e datës 22.01.2021 parashihet që “Për çdo vit të

përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”.

Sipas nenit 35 paragrafi 11 i Kontratës Kolektive nr. 105 e datës 22.01.2021 parashihet që *“Punëtorëve (anëtarëve të SBASHK-ut) në fund të çdo viti kalendarik u jepet shpërblim në lartësi prej 8.3% të pagës vjetore kumulative, nga momenti që MASH, SBASHK dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave do të siguronin mjetet financiare për këtë kompensim. Zbatimi i kësaj mase lidhet me përmirësimin e përformancës së sistemit(për shembull përmes rezultateve të përmirësuar në testin PISA dhe testet relevante të standardizuara ndërkombëtare), të insitucionit ose të mësimdhënësve individualë sipas vlerësimit të punëdhënësit.*

Në kuptim të nenit 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*

Kurse, në kuptim të nenit 399, paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet që *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”.*

5. Vlerësimet përfundimtare të gjykatës

Gjykata, pas vlerësimit të provave konstatojë se kërkesëpadija e paditësve duhet të aprovohet **pjesërisht si e bazuar**. Për gjykatën nuk ishte kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura si mësimdhënës, madje kjo gjë nuk është kontestuar as nga ana e palës së paditur. Poashtu nuk ishte kontestuese nga ana e palës së paditur as fakti se paditësve ju takon kompensimi në emër të inflacionit, mirëpo kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse ishte detyrimi që paditësve t’i kompensohet përqindja e inflacionit në pagë për muajin Janar 2021 dhe muajin Nëntor 2022 si dhe pagesa për shpërblimin në emër të 8.3% të pagës vjetore kumulative.

Gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit pjesërisht aprovues jashtë seancës. Duke, u bazuar në nenin 35 paragrafi 10 të Kontratave Kolektive të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021 rrjedh se e paditura për çdo vit duhet ta kompensoj shkallën e inflacionit në pagën e të punësuarve të saj e në këtë rast edhe paditësve.

Andaj, duke marrë parasysh se paditësja Sh...P... pagën për vitin 2021 e ka pasur në lartësi prej 489.07€, kurse shkalla e inflacionit për këtë vit ka qenë 3.4 %, kur të llogaritet shkalla e inflacionit sipas formulës $489.07\text{€} \times 12 \text{ muaj} = 5.868,84 \text{€} \times 3.4 \% = 199.54 \text{€}$, rrjedh se detyrimi i të paditurës ndaj paditësit për vitin 2021 është në lartësi prej 199.54€, ndërsa pagën për vitin 2022 e ka pasur në lartësi prej 489.07€, kurse shkalla e inflacionit për këtë vit ka qenë 11.6 %, kur të llogaritet shkalla e inflacionit sipas formulës $489.07\text{€} \times 10 \text{ muaj} = 4,890.70\text{€} \times 11.6\% = 567.32 \text{€}$, si dhe për muajin Nëntor (deri me 22.11.2022), detyrimi i të paditurës ndaj paditësit është në shumë prej 41.25 €, andaj, rrjedh se shuma e përgjithshme për kompensim për periudhën 01.01.2021 deri me 22.11.2022 është në lartësi prej 808.11€.

Paditësja N...Zh... pagën për vitin 2021 e ka pasur në lartësi prej 491.03€, kurse shkalla e inflacionit për këtë vit ka qenë 3.4 %, kur të llogaritet shkalla e inflacionit sipas formulës 491.03€

$x 12 \text{ muaj} = 5,892.36\text{€} \times 3.4 \% = 200.00 \text{ €}$, rrjedh se detyrimi i të paditurës ndaj paditësit për vitin 2021 është në lartësi prej 200.00 €, ndërsa pagën për vitin 2022 e ka pasur në lartësi prej 491.03€, kurse shkalla e inflacionit për këtë vit ka qenë 11.6 %, kur të llogaritet shkalla e inflacionit sipas formulës $491.03\text{€} \times 10 \text{ muaj} = 4,910.30\text{€} \times 11.6\% = 569.59 \text{ €}$, si dhe për muajin Nëntor (deri me 22.11.2022), detyrimi i të paditurës ndaj paditësit është në shumë prej 48.05 €, andaj rrjedh se shuma e përgjithshme për kompensim për periudhën 01.01.2021 deri me 22.11.2022, është në lartësi prej 817.64€.

Paditësja Sh...R.... U.. pagën për vitin 2021 e ka pasur në lartësi prej 507.08€, kurse shkalla e inflacionit për këtë vit ka qenë 3.4 %, kur të llogaritet shkalla e inflacionit sipas formulës $507.08\text{€} \times 12 \text{ muaj} = 6.084,00 \text{ €} \times 3.4 \% = 206.85 \text{ €}$, rrjedh se detyrimi i të paditurës ndaj paditësit për vitin 2021 është në lartësi prej 206.85 €, ndërsa pagën për vitin 2022 e ka pasur në lartësi prej 507.08€, kurse shkalla e inflacionit për këtë vit ka qenë 11.6 %, kur të llogaritet shkalla e inflacionit sipas formulës $507.08\text{€} \times 10 \text{ muaj} = 5,070.80\text{€} \times 11.6\% = 588.21 \text{ €}$, si dhe për muajin Nëntor (deri me 22.11.2022), detyrimi i të paditurës ndaj paditësit është në shumë prej 42.00 €, andaj rrjedh se shuma e përgjithshme për kompensim për periudhën 01.01.2021 deri me 22.11.2022, është në lartësi prej 837.06€, mirëpo të njëjtës i aprovohet vetëm shuma prej 823.59€, sepse këtë shumë e ka kërkuar në kërkesëpadi dhe gjykata nuk mund ta tejkaloj kërkesëpadinë.

Paditësi S...J... pagën për vitin 2021 e ka pasur në lartësi prej 469.51€, kurse shkalla e inflacionit për këtë vit ka qenë 3.4 %, kur të llogaritet shkalla e inflacionit sipas formulës $469.51\text{€} \times 12 \text{ muaj} = 5.634,12 \text{ €} \times 3.4 \% = 191.56 \text{ €}$, rrjedh se detyrimi i të paditurës ndaj paditësit për vitin 2021 është në lartësi prej 191.56 €, ndërsa pagën për vitin 2022 e ka pasur në lartësi prej 469.51€, kurse shkalla e inflacionit për këtë vit ka qenë 11.6 %, kur të llogaritet shkalla e inflacionit sipas formulës $469.51 \times 10 \text{ muaj} = 4,6950.10\text{€} \times 11.6\% = 544.63\text{€}$, si dhe për muajin Nëntor (deri me 22.11.2022), detyrimi i të paditurës ndaj paditësit është në shumë prej 39.46€, andaj rrjedh se shuma e përgjithshme për kompensim për periudhën 01.01.2021 deri me 22.11.2022, është në lartësi prej 775.65€.

Paditësi G...A... pagën për vitin 2021 e ka pasur në lartësi prej 501.22€, kurse shkalla e inflacionit për këtë vit ka qenë 3.4 %, kur të llogaritet shkalla e inflacionit sipas formulës $501.22\text{€} \times 12 \text{ muaj} = 6.014,64\text{€} \times 3.4 \% = 204.49 \text{ €}$, rrjedh se detyrimi i të paditurës ndaj paditësit për vitin 2021 është në lartësi prej 204.49 €, ndërsa pagën për vitin 2022 e ka pasur në lartësi prej 501.22€, kurse shkalla e inflacionit për këtë vit ka qenë 11.6 %, kur të llogaritet shkalla e inflacionit sipas formulës $501.22\text{€} \times 10 \text{ muaj} = 5,012.2\text{€} \times 11.6\% = 581.41 \text{ €}$, si dhe për muajin Nëntor (deri me 22.11.2022), detyrimi i të paditurës ndaj paditësit është në shumë prej 42.28 €, andaj rrjedh se shuma e përgjithshme për kompensim për periudhën 01.01.2021 deri me 22.11.2022, është në lartësi prej 828.18€.

Lidhur me pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi gjykata ka refuzuar kërkesën e paditësve sa i përket kompensimit në pagë-inflacion për periudhën 23.11.2022 deri me 30.11.2022, pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit në mënyrë të njëanshme është ndërprerë me 22 nëntor të vitit 2022, andaj duke marrë parasysh të lartëcekurat gjykata vlerëson se nuk i'u takon e drejta e kompensimit në pagë-inflacion dhe si të tillë gjykata refuzoj kërkesëpadinë sa i përket periudhës 23.11.2022 deri me 30.11.2022.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, u vendos në kuptim të nenit 452 të LPK dhe Rregullorës për tarifën e avokatëve, dhe në bazë të specifikimit të shpenzimeve nga paditësit me anë të parashtrësës së datës 22.11.2022 duke e obliguar të paditurën, që paditësve t'i kompensoj

shumën në lartësi prej 312.00 € në emër të përpilimit të padisë dhe 21.00 € në emër të pagesës së taksës gjyqësore.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në kuptim të nenit 7 dhe 8, lidhur me nenin 143, 398 dhe 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.389/2022, datë 08.04.2024

Gjyqtari
Fuad Haliti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 dite pas marrjes së të njejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.